



Prishtinë: 22.12.2010

Kodi i ZRRE-së: V_328_2010

Nr. i Referencës: ZRRE/DMK_R_505_12_10

Bordi i Zyrës së Rregullatorit për Energji

Duke marrë parasysh:

1. Kompetencat e Zyrës së Rregullatorit për Energji të dhëna në nenin 16 të Ligjit për Rregullatorin e Energjisë;
2. Dispozitat sipas Kapitullit 3, Nenit 14.6 të Rregullës mbi Procedurën e Zgjidhjes së Kontesteve në Sektorin e Energjisë;
3. Dëshmitë e paraqitura nga palët;
4. Rekomandimin e DMK të ZRRE-së: **ZRRE/DMK_R_505_12_10**;
5. Nenin 18 të Rregullës mbi Procedurën e Zgjidhjes së Kontesteve në Sektorin e Energjisë;

Në mbledhjen e mbajtur më 22 dhjetor 2010 nxori këtë:

VENDIM

APROHOHET pjesërisht ankesa e konsumatorit Hetem Musliu, nga Skenderaj si në arsyet e paraqitura në arsyetimin e këtij vendimi.

Arsyetim

Konsumatori në ankesën e tij drejtuar DMK të ZRRE-së të 24.03.2009 ka apeluar përgjigjen e KEK Sh.A – Divizioni i Furnizimit – Departamenti për Konsumatorë të datës 23.03.2009, lidhur me kontestimin e ngarkesës së shfrytëzimit të paautorizuar.

- Me datë 17.01.2005 punëtorët e autorizuar të KEK-ut kanë inspektuar pikën matëse te konsumatori dhe kanë konstatuar se konsumatori pala e shfrytëzon energjinë elektrike në lokal pa njehsor si dhe kanë marrë pajisjet në lokal. Në Procesverbalin e KEK-ut theksohet se pala duhet të vendos njehsorin elektrik në afat prej 2 ditësh dhe të lajmërohet në KEK.
Provë: Procesverbali i KEK-ut i datës 17.01.2005
- Me datë 18.04.2005 punëtorët e autorizuar të KEK-ut kanë inspektuar pikën matëse te konsumatorit dhe kanë bërë ndërrimin dhe heqjen e njehsorit elektrik, ku kanë evidentuar se pala ka qenë pa njehsor/paushall ndërsa kanë bërë regjistrimin e njehsorit elektrik nr. 39411533.
Provë: Vërtetimi mbi heqjen dhe ndërrimin e njehsorit elektrik nr. 4 të datës 18.04.2005
- Me datë 21.06.2005 KEK-u e ngarkon konsumatorin me ngarkesë për shfrytëzim të paautorizuar me anë të faturës 2607DMI-9029101-9029101 në vlerë prej 636.72 €.
Provë: Fatura e KEK-ut 2607DMI-9029101-9029101 e datës 21.06.2005

- Me datë 26.11.2008 punëtorët e autorizuar të KEK-ut kanë inspektuar pikën matëse te konsumatori dhe kanë konstatuar se njehsori elektrik është trefazor dytarifor pesë shifror i cili teknikisht është në rregull si dhe ka qenë me vulë (bllomb) distributive nr. 000448. Pas kontrollimit është vulosur me vulë distributive nr. 40034023. Në procesverbal punëtorët e KEK-ut kanë theksuar se konsumatori posedon një lokal (ordinancë).
Provë: Procesverbali i KEK-ut nr. 158582 i datës 26.11.2008
- Me datë 16.01.2009 punëtorët e autorizuar të KEK-ut kanë inspektuar pikën matëse te konsumatori dhe kanë konstatuar se njehsori elektrik është trefazor, njehsori elektrik i konsumatorit në momentin e kontrollës ka qenë i vulosur me vulë A40034023, e kemi këputur vulën si dhe është bërë kontrollimi teknik i njehsorit elektrik, në momentin e kontrollës njehsori elektrik teknikisht ka qenë në rregull. Njehsori elektrik është vulosur me vulë A10088413.
Provë: Procesverbali i KEK-ut nr. 1170684 i datës 16.01.2009
- Me datë 23.01.2009 punëtorët e autorizuar të KEK-ut kanë inspektuar pikën matëse te konsumatori dhe kanë konstatuar se konsumatori paguan energjinë elektrike në shifrën DMI – 9023089 me nr. njehsori 39411533 e me gjendje TL = 01408 dhe TU = 00004 dhe i vulosur me vulë nr. A10088413. Punëtorët e KEK-ut në procesverbal kanë konstatuar se borxhi i cili i kërkohet konsumatorit në shifrën DMI – 9029101 është shifër e dyfishtë pasi që pala ka një lokal.
Provë: Procesverbali i KEK-ut nr. 247851 i datës 23.01.2009
- Konsumatori ka parashtruar ankesë në Departamentin për Konsumatorë në KEK duke kundërshtuar ngarkesën për shfrytëzim të paautorizuar.
Provë: Ankesa e konsumatorit në KEK
- Me datë 23.03.2009 Departamenti për Konsumatorë në KEK iu është përgjigjur konsumatori duke e refuzuar ankesën e konsumatorit.
Provë: Përgjigja e KEK-ut e datës 23.03.2009
- Me datë 24.03.2009 konsumatori ka apeluar përgjigjen e KEK-ut në DMK të ZRRE-së.
Provë: Ankesa e konsumatorit në DMK të ZRRE-së
- Me datë 08.12.2009 DMK në pajtim me paragrafin 14.3 të nenit 14 të Rregullit mbi Procedurën për Zgjidhjen e Kontesteve në Sektorin e Energjisë, ka analizuar ankesën e konsumatorit dhe ka dërguar KEK-ut për rishqyrtim.
Provë: Shkresa e DMK-së dërguar KEK-ut (Departamentit për Konsumatorë) për rishqyrtimin e ankesave të konsumatorëve
- Me datë 21.05.2010 Komisioni i KEK-ut në përbërje të stafit përgjegjës të operatorit të rrjetit dhe furnizuesit publik, ka refuzuar prapë ankesën e konsumatorit.
Provë: Vendimi i Komisionit të KEK-ut të datës 21.05.2010

DMK në ZRRE duke analizuar të gjitha dëshmitë e paraqitura nga ana e konsumatorit dhe KEK-ut, ka vërejtur se:

- ✓ Komisioni i KEK-ut pasi ka marrë lëndën e konsumatorit në rishqyrtim, ka analizuar ankesën e konsumatorit dhe ka refuzuar ankesën e konsumatorit në arsyetimin se: *“konsumatori ka*

patur shifrën DMI – 9023089 në të cilin është ngarkuar me vlerësim mesatar E. Më dt. 17.01.2005 sipas procesverbalit të kontrollës nr. xxxx konsumatori Hetem Musliu shfrytëzon rrymën në lokal pa orë të rrymës. Në bazë të këtij procesverbali me dt. 18.01.2005 i është bërë evidentimi i pajisjeve sipas të cilit me dt. 08.02.2005 i është kalkuluar RH në vlerë 636.72 €. Por me këtë rast konsumatorit i është hapur shifra e re DMI – 9029101 me grup tarifor 9/3 në të cilin edhe është ekzekutuar RH. Më dt. 23.01.2009 ekip i kontrollës plotëson procesverbalin nr. 247851 sipas të cilit vlerësohet se konsumatori DMI – 9029101 është shifër e dyfishtë dhe se shifra e rregullt është DMI – 9023089 dhe ka njehsorin nr. 39411533 me gjendje A1 = 1408 kW dhe A2=0004 kW. Më dt. 26.01.2009 komisioni vendos që: shifra DMI – 9029101 të pasivizohet kurse shuma e RH dh ngarkesat paushalle nga muaji 02/2005 deri 07/2005 (kur është regjistruar njehsori) nga 73.65 € për muajt 2;3;4;5;6 dhe 7/2005 duhet të barten në shifrën DMI – 9023089. Kjo shumë për transfero është $636.72+441.9 = 1,078.72€$. deri më 07/2005 konsumatori në shifrën DMI – 9023089 është ngarkuar me shumën 492.22 (deri në vendosjen e njehsorit), prandaj korrigjimi total duhet të jetë $1,078 - 492.22=586.50$ €.

Provë: Vendimi i Komisionit të KEK-ut të datës 05.05.2010

- ✓ Komisioni i KEK-ut në vendimin e tyre pas rishqyrtimit të lëndës së konsumatorit ka refuzuar ankesën e konsumatorit në arsyetimin se: *konsumatori ka patur shifrën DMI – 9023089 në të cilin është ngarkuar me vlerësim mesatar E. Më dt. 17.01.2005 sipas procesverbalit të kontrollës nr. xxxx konsumatori Hetem Musliu shfrytëzon rrymën në lokal pa orë të rrymës. Në bazë të këtij procesverbali me dt. 18.01.2005 i është bërë evidentimi i pajisjeve sipas të cilit me dt. 08.02.2005 i është kalkuluar RH në vlerë 636.72 €. Por me këtë rast konsumatorit i është hapur shifra e re DMI – 9029101 me grup tarifor 9/3 në të cilin edhe është ekzekutuar RH. Më dt. 23.01.2009 ekip i kontrollës plotëson procesverbalin nr. 247851 sipas të cilit vlerësohet se konsumatori DMI – 9029101 është shifër e dyfishtë dhe se shifra e rregullt është DMI – 9023089 dhe ka njehsorin nr. 39411533 me gjendje A1 = 1408 kW dhe A2=0004 kW. Më dt. 26.01.2009 komisioni vendos që: shifra DMI – 9029101 të pasivizohet kurse shuma e RH dh ngarkesat paushalle nga muaji 02/2005 deri 07/2005 (kur është regjistruar njehsori) nga 73.65 € për muajt 2;3;4;5;6 dhe 7/2005 duhet të barten në shifrën DMI – 9023089. Kjo shumë për transfero është $636.72+441.9 = 1,078.72€$. deri më 07/2005 konsumatori në shifrën DMI – 9023089 është ngarkuar me shumën 492.22 (deri në vendosjen e njehsorit), prandaj korrigjimi total duhet të jetë $1,078 - 492.22=586.50$ €.*

Provë: Vendimi i Komisionit të KEK-ut të datës 21.05.2010

- ✓ Me datë 21.06.2006 Gjykata Komunale në Skenderaj me anë të Aktgjykimit ka shpallur fajtor konsumatorin Hetem Musliu.

Provë: Aktgjykimi i Gjykatës Komunale i datës nr. P.nr.59/2006 të datës 21.06.206

- ✓ Sipas transaksioneve të konsumatorit shifra DMI – 9023089 është hapur nga ana e KEK-ut në periudhën 01/2003 kur edhe konsumatorit i ka arritur konsumatorit fatura e parë e energjisë elektrike. Në këto transaksione të konsumatorit vërehet se KEK-u konsumatorin e ka ngarkuar me faturim pa matje apo me vlerësim mesatar, po ashtu vërehet se në këtë transaksion është si konsumator ilegal i regjistruar.

Provë: Transaksionet e konsumatorit për shifrën DMI – 9023089

- ✓ Konsumatorit kur iu është hapur shifra DMI – 9029101 nga ana e KEK-ut, është faturuar në të njëjtën kohë edhe në shifrën DMI – 9023089. Sipas transaksioneve të konsumatorit në shifrën DMI – 9023089 konsumatori ka qenë duke u faturuar pa matje ma fatura të energjisë elektrike prej periudhës 01/2003 e deri kur edhe është bërë ndërrimi i njehsorit elektrik me datë 18.04.2005. Shifra DMI – 9029101 të cilën KEK-u i ka hapur konsumatorit duke e

ngarkuar me rikthim të humbjeve me datë 21.06.2005 është hapur gabimisht pasi që paraprakisht konsumatori ka pasur shifër të hapur. Në transaksionet e konsumatorit të shifrës DMI – 9029101 vërehet se pas ngarkesës së konsumatorit me rikthim të humbjeve KEK-u e ka faturuar konsumatorin me faturim pa matje/paushall në vlerë prej 73.65 €. Sipas vërtetimit mbi ndërrimin e njehsorit elektrik nr. 4 të datës 18.04.2005, vërehet se punëtorët e autorizuar të KEK-ut kanë bërë regjistrimin e njehsorit elektrik nr. 394144533 i cili njehsor është regjistruar në shifrën DMI – 9023089 dhe se ky njehsor ka qenë i regjistruar zyrtarisht.
Provë: Transaksionet e konsumatorit: shifra DMI – 9023089 dhe DMI – 9029101

- ✓ Punëtorët e autorizuar të KEK-ut në vërtetimin mbi ndërrimin e njehsorit elektrik nr. 4 të datës 18.04.2005 kanë evidentuar se konsumatori ka qenë pa njehsor elektrik dhe është faturuar pa matje – paushall, ndërsa ka bërë regjistrimin e njehsorit elektrik nr. 39411533. Në vërtetimin mbi ndërrimin e njehsorit elektrik KEK-u ka evidentuar shifrën DMI – 9023089 në emër të Hetem Musliu nga fshati Likofc.
Provë: Vërtetimi mbi ndërrimin e njehsorit elektrik të datës 18.04.2005
- ✓ Punëtorët e autorizuar të KEK-ut në procesverbalin e tyre të përpiluar me datë 17.01.2005 kanë konstatuar se konsumatori e shfrytëzon energjinë elektrike në lokal pa njehsor elektrik, si dhe i kanë afat konsumatorit të vendos njehsor elektrik. Punëtorët e KEK-ut procesverbalin e kanë përpiluar në emër të Hetem Musliu nga fshati Likofc dhe e kanë evidentuar si konsumator komercial. Në procesverbal nuk është evidentuar se shifra e konsumatorit apo se a ka qenë më herët konsumatori duke u faturuar me fatura të energjisë elektrike apo vetëm se nuk ka pasur njehsor elektrik.
Provë: Procesverbali i KEK-ut i datës 17.01.2005
- ✓ KEK-u ka përpiluar një procesverbal me datë 18.01.2005 duke bërë edhe llogaritjen e energjisë së paautorizuar, por që edhe në procesverbal nuk vërehet numri i procesverbalit dhe se nuk është evidentuar shifra e konsumatorit.
Provë: Procesverbali i KEK-ut i datës 18.01.2005
- ✓ Departamenti i Furnizimit – Divizioni i Shitjes, Sektori i faturimit i KEK-ut ka bërë llogaritjen e shfrytëzimit të paautorizuar në vlerë 636.72 €. Në këtë faturë është evidentuar emri konsumatorit Hetem Musliu nga fshati Likofc dhe se shifra e konsumatorit 9029101.
Provë: llogaritja e shfrytëzimit të paautorizuar e datës 08.02.2005
- ✓ KEK-u me anë të urdhër lejimit / ngarkimit nr. 2607 e me datë 21.06.2005 ka ngarkuar konsumatorin me shfrytëzim të paautorizuar të energjisë elektrike në vlerë prej 636.72 €.
Provë: Urdhër lejimi / ngarkimi nr. 2607 i datës 26.01.2005
- ✓ Sipas transaksionit të konsumatorit KEK-u shifrën e konsumatorit DMI – 9029101 në emër të Hetem Musliu e ka hapur me datë 21.06.2005 duke e ngarkuar konsumatorin me shfrytëzim të paautorizuar të energjisë elektrike.
Provë: Transaksionet e konsumatorit DMI – 9029101
- ✓ Punëtorët e KEK-ut në procesverbalin nr. 247851 të datë 23.01.2009 kanë konstatuar se konsumatori Hetem Musliu nga fashti Likoc, konsumator komercial faturat e energjisë elektrike i paguan në shifrën DMI – 9023089, ndërsa konsumatori ka edhe një shifër tjetër DMI – 9029101 e cila shifër është e dyfishtë dhe se pala ka vetëm një lokal (ordinancë) private.
Provë: Procesverbali i KEK-ut nr. 247851 i datës 23.01.2009

- ✓ KEK-u me anë të urdhër lejimit / ngarkimit nr. 8400 e me datë 27.01.2009 ka bërë një korigjim në shifrën e konsumatorit DMI – 9023089, ku në përshkrimin e urdhëri lejimit / ngarkimit theksohet: “B11 RC01 r Korigjim i transferit të borxhit nga shifra 9029101, ngarkohet shuma prej 586.50 €”.
Provë: Urdhër lejimi / ngarkimi nr. 8400 i datës 27.01.2009
- ✓ KEK-u me anë të urdhër lejimit / ngarkimit nr. 8399 e me datë 27.01.2009 ka bërë një korigjim në shifrën e konsumatorit DMI – 9029101, ku në përshkrimin e urdhër lejimit / ngarkimit theksohet: “B11 RC01 r Korigjim i faturave të dyfishta me shifrën 9023089 korigjohet shuma e borxhit dhe pasivizohet”.
Provë: Urdhër lejimi / ngarkimi nr. 8399 i datës 27.01.2009
- ✓ Në përgjigjen e KEK-ut dhënë konsumatorit theksohet se konsumatori ka dy shifra dhe se Shifra DMI – 9029101 konsumatori ka dy shifra dhe se shifra DMI – 9029101 është hapur me rikthim të humbjeve me datë 17.01.2005, pasi konsumatori ka qenë pa njehsor elektrik dhe se është ngarkuar në vlerë prej 636.72 €. Pas kësaj, konsumatori ka vendosur njehsorin elektrik dhe iu është hapur shifra DMI – 9023089 në vend se t’i regjistrohet njehsori në shifrën DMI – 9029101. Me korigjimin e bërë të datës 27.01.2009 konsumatorit i pasivizohet shifra DMI – 9029101 dhe i është korigjuar shume prej 4036.07 €. Nga shifra DMI – 9029101 është bartur rikthimi i humbjeve në vlerë prej 636.72 € dhe se shuma prej 441.90 € për 6 vlera të paushallit prej 73.65 € deri në kohën kur konsumatori ka vendosur njehsorin elektrik. Gjatë kësaj kohe konsumatori është ngarkuar në vlerë prej 492.22 € vlerë kjo e cila është korigjuar nga vlera e shumës 636.72 € + 441.90€, prandaj vlera e korigjimit për shifrën DMI – 9023089 është 586.50 €. Bazuar në përgjigjen e KEK-ut dhënë konsumatorit me datë 23.03.2009, DMK ka vërejtur se brenda përgjegjës së KEK-ut ka disa paqartësi, pasi që sipas dëshmive vërehet se shifra e konsumatorit DMI – 9023089 është hapur nga periudha 01/2003 e jo siç theksohet në përgjigjen e KEK-ut se është hapur me regjistrimin e njehsorit të ri. Shifra e konsumatorit DMI – 9029101 është hapur me datë 21.06.2005 duke e ngarkuar konsumatorin me ngarkesë për rikthim të humbjeve. KEK-u në përgjigjen e konsumatorit thekson se konsumatorit nuk iu është dashur t’i hapet shifra DMI – 9023089, por që njehsori të regjistrohet në shifrën DMI – 902910. Por sipas dëshmive del se shifra DMI- 9023089 ka qenë e hapur para shifrës DMI – 9029101 dhe se njehsori i regjistruar është regjistruar saktë në atë shifër. Sipas analizave vërehet se rikthimi i humbjeve në vlerë 636.72 € duhet të bartet nga shifra DMI – 9029101 në shifrën DMI – 9023089, ndërsa faturat tjera të cilat siç theksohet në përgjigjen e KEK-ut për vlera të paushallit prej 73.65 € të faturuar në shifrën DMI – 9029101 nuk është dashur të faturohen pasi që konsumatori ka qenë duke u faturuar në shifrën DMI – 9023089.
Provë: Përgjigja e KEK-ut e datë 23.03.2009
- ✓ Në ankesën e konsumatorit theksohet se punëtorët e KEK-ut kanë premtuar se do të ipen njehsorët elektrik falas, por që jam informuar se për lokale nuk ipen. Pas një periudhe vjen një faturim pa matje/paushall në vlerë prej 441 €, e pastaj në të njëjtë shifër më vjen edhe vlera 636.72 €, i cili borxh është kundërshtuar. Pastaj vjen një ekipi i kontrollës dhe e gjejnë pa njehsor elektrik, ku përpilohet procesi dhe kërkohet të lajmërohet në KEK për dy ditë. Sipas punëtorëve të KEK-ut kam montuar njehsorin por që KEK-u nuk ka regjistruar njehsorin elektrik me kohë, por që me datë 18.04.2005 ka bërë regjistrimin e njehsorit elektrik. KEK-u ka paditur konsumatorin për vlerën prej 636.72 €. Pasi jam informuar se kyçje pa leje është vepër penale kam pranuar këtë borxh dhe dënimin e gjykatës së datës 21.06.2006. Edhe pas kësaj KEK-u ka vazhduar faturimin e dyfishtë ndërsa isha duke u faturuar me faturat e

rregullta. Pas kësaj menjëherë kam njoftuar KEK-un për këtë faturim të dyfishtë. KEK-u asnjëherë nuk ka dalur për të inspektuar gjendjen në teren, dhe se pas kësaj prapë kam parashtruar ankesë në KEK me datë 06.02.2006. Prapë KEK-u ka vazhduar me të vjetrën deri sa borxhi ka arritur vlerën prej 3650.57 €. Për këtë jemi ballafaquar në gjykatë dhe se pas tre seancave janë tërhequr dhe gjykata ka shpallur të pafajshëm me datë 27.01.2009 lënda C-nr.226/08. Por që KEK-u prapë dhe pas asnjë arsye më ka bartur shumën prej 586.50 €. Edh për këtë kam parashtruar ankesë në KEK por jam refuzuar nga ana e KEK-ut.

DMK duke u bazuar në analizat e cekura më lartë, rekomandon Bordin e ZRRE-së që të **aprovjë pjesërisht** ankesën e konsumatorit dhe kërkon nga KEK-u që:

1. Fatura e KEK-ut 2607DMI-9029101-9029101 e datës 21.06.2005 në vlerë prej 636.72 €, mbetet në fuqi sipas vendimit të Gjykatës Komunale në Skenderaj të datës 21.06.2006.
2. Të pasivizohet shifra e konsumatorit DMI – 9029101 dhe të lirohet konsumatori nga faturat e energjisë elektrike prej periudhës 05/2005 e deri te periudha e korigjimit e datës 27.01.2009 në këtë shifër.

Bordi i ZRRE-së ka rishikuar të gjitha dokumentet dhe argumentet e paraqitura dhe pas analizës së lëndës së konsumatorit ka vendosur që ta **aprovjë pjesërisht** ankesën e konsumatorit për arsyet e paraqitura në rekomandimin e DMK të ZRRE-së.

Sipas këtij vendimi, KEK-u është i obliguar që:

1. Fatura e KEK-ut 2607DMI-9029101-9029101 e datës 21.06.2005 në vlerë prej 636.72 €, mbetet në fuqi sipas vendimit të Gjykatës Komunale në Skenderaj të datës 21.06.2006.
2. Të pasivizohet shifra e konsumatorit DMI – 9029101 dhe të lirohet konsumatori nga faturat e energjisë elektrike prej periudhës 05/2005 e deri te periudha e korigjimit e datës 27.01.2009 në këtë shifër.

Këshillë Juridike: Kundër këtij Vendimi, pala ka të drejtë të iniciojë procedurë gjyqësore në Gjykatën Kompetente, brenda **katërmbëdhjetë (14) ditësh** prej ditës së pranimit të këtij Vendimi.

Bordi i ZRRE-së

Dr. Ali Hamiti, kryesues

Theranda Beqiri, anëtare

Përparim Kabashi, anëtar

Blerim Koci, anëtar